



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
**Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority**



**Vendim Nr. 71/23**  
**Data: 26.07.2023**

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe 55 par 1.5 të Ligjit nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 26.07.2023, mori këtë;

## V E N D I M

**I. LEJOHET** Përqendrimi i ndërmarrjeve: lidhur me krijimin e një Ndërmarrje të Përbashkët me funksion të plotë në mes Shoqërive Tregtare Societe des Produits Nestle S.A., dhe PAI Partners S.a.r.l.

Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve të lidhur me datë 21 Prill 2023, ndërmjet Societe des Produits Nestle S.A., dhe PAI Partners S.a.r.l.

**Societe des Produits Nestle S.A.**, është pjesë e grupit të kompanive (Nestle Group), me seli në Avenue Nestle 55, Vevey 1800, Switzerland me numër të biznesit CHE – 105.909.036. Nestle është kompani Zvicerane, e cila merret kryesisht me prodhimin, marketingun dhe shitjen e një numri të madh produktesh ushqimore dhe pijesh, duke përfshirë produktet e qumështit, kafe, ujë të paketuar, drithëra, produkte të kuzhinës duke përfshirë ushqimin e përgatitur, erëza, salca dhe makarona të thata, akullore, pije me çokolatë, çaj dhe produkte ëmbëlsirash etj.

**PAI Partners S.a.r.l.** është kompani tërësisht në pronësi të PAI Partners S.A.S, me adresë në 53, Boulevard Royal, L-2449 Luksemburg, Duka i Madh i Luksemburgut, me numër të biznesit B136689. PAI është kompani e shquar evropiane e kapitalit privat me seli në Paris, Francë, ajo ka zyre edhe në Londër, Luksemburg, Madrid, Milano, Mynih, New Jork dhe Stokholm, e cila merret kryesisht me menaxhimin e fondeve të dedikuara të kapitalit privat. Partners S.a.r.l., për qëllim të transaksionit, PAI ka ngritur një mjet investimi, kompaninë Immunity Invesments S.a.r.l., (që do të riemërohet Vesuvio Invesment S.a.r.l., me zyrën e saj të regjistruar në 53, Boulevard Royal, L-2449 Luxembourg, Duka i Madh i Luksemburgut, regjistri nr. B247112, (Immynity Invesment), i cili do të blejë interesa në biznesin SP, nga ana tjetër Immunity Invesments do të kontrollohet dhe menaxhohet nga PAI, ndërmarrja e përbashkët do të zhvilloj aktivitetin e saj në lidhje me biznesin e picave të ngrira të Nestle (biznesi SP), duke përfshirë kërkimin, zhvillimin, reklamimin, promovimin, prodhimin, paketimin dhe

pg. 1

shpërndarjen e produkteve të picave të ngrira, në vendet si; Andora, Belgjikë, Republikën Çeke, Danimarkë, Gjermani, Greqi, Hungari, Islandë, Itali, Portugali, Spanjë, Zvicërr, Maltë, Sllovaki, Suedi, Mbretërinë e Bashkuar, Francë.

Biznesi i picave i Nestlé, aktualisht shpërndahen nën markat Wagner, Buitoni dhe Garden Gourmet. Biznesi do të ketë selinë në Gjermani dhe do të operojë dy objekte prodhuese, në Nonnweiler, Gjermani dhe Benevento, Itali.

### **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumë 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i një pale në tregun e brendshëm e kalon shumë 1,000,000 Euro.
- c) Më datë 21 Prill 2023, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve të lidhur ndërmjet Societe des Produits Nestle S.A., dhe PAI Partners S.a.r.l.
- d) Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se palët realizojn të hyra përmes shitjeve në Republikën e Kosovës.

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, e paraqitur në bazë të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11, 13, 17, 18, si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

### **Procedurat e ndjekura:**

1. Vlerësimi i Lëndës;
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 29.06.2023;
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 29.06.2023;
4. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Marrëveshjen lidhur me datë 21.04.2023; ndërmjet palëve Societe des Produits Nestle S.A., dhe PAI Partners S.a.r.l.

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguajë taksën administrative prej 100.00 € me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18, të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenit 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja, (tre mijë) Euro.

### **ARSYETIM**

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 26.05.2023, me Nr. Prot. 240/23-01/H ka pranuar kërkesën për Përqendrim përmes përfaqësuesit ligjor z. Virtyt Ibrahimaga lidhur me krijimin e një Ndërmarrje të Përbashkët me funksion të plotë mes Shoqërive Tregtare Societe des Produits Nestle S.A., dhe PAI Partners S.a.r.l.

### **Analiza e Konkurrencës**

Ndërmarrjet Nestle dhe PAI Partners nuk kanë degë të regjistruar në Kosovë, e gjithë shitja realizohet përmes distributorëve të autorizuar. Ndërmarrja e Përbashkët (SP) e cila është target i këtij transaksioni gjithë aktivitetin e saj do ta shtrijë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, pra në vendet e BE-së dhe më gjerë, palët në këtë përqendrim nuk janë në vijën e njëjtë horizontale prandaj transaksioni nuk do të forcoj asnjë pozicion dominues tek palët në përqendrim dhe si i tillë nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun e Kosovës, pra, nuk do të shkaktojë efekte negative në konkurrencë në tregun kosovar dhe as tek konsumatorët.

**Tregu Relevant** - Struktura e tregut do të mbetet e pandryshuar në Republikën e Kosovës.

**Tregu i produktit** - tregu i picave të ngrira duke përfshirë kërkimin, zhvillimin, reklamimin, promovimin, prodhimin, paketimin dhe shpërndarjen e produkteve të picave të ngrira.

**Tregu gjeografik** - pasi që targeti i këtij transaksioni është krijimi i një Ndërmarrje të Përbashkët me funksion të plotë i cili nuk do të shtrijë aktivitetin e tij në Republikën e Kosovës, por në vendet e BE-së dhe më gjerë i njëjti do të përcaktohet edhe si treg Ndërkombëtar.

**Tregjet e Prekura** - Transaksioni, nuk do të shkaktojë ndonjë rritje të pjesës së tregut, pra do ta ruajë pozicionin aktual në tregun relevant në Republikën e Kosovës pasi që, transaksioni realizohet jashtë territorit të Kosovës.

### **Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv, të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)